

UDHËZIM

Nr.24, datë 6.3.2009

PËR PËRCAKTIMIN E EKSTREMITETEVE TË PULLAVE TË SIGURISË

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 24 pika 7 të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Ekstremitetet e pullës së rregullsisë që lëshohen dhe vendosen te çdo makinë nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (NJMLF) janë si më poshtë:
 - a) Pullat e sigurisë duhet të kenë përmasat e nevojshme, 35*35mm, për të mbyllur kapakun e memories së makinave në mënyrë që të mos manipulohet.
 - b) Të kenë ngjitës ekstra të fortë.
 - c) Numrin serial progresiv.
 - ç) Holograma të jetë me ndryshim ngjyrash nga pjerësimi dhe me mikrotekst "Ministria e Financave" dhe shqiponja. Mikroteksti "Ministria e Financave" dhe "shqiponja" të jenë të gdhendura me laser "laser engrave". Këto specifikime miratohen në kontratën që lidhet nga NJMLF me Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë.
 - d) Emrin e kodit të llojit të certifikatës dhe viti i verifikimit.
 - dh) Sfondi, forma, ngjyrat dhe lloji i shkrimit, dhe elemente të tjera përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.
2. Vlefshmëria e pullave të sigurisë është njëvjeçare.
Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode